



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MIRËQENIES SOCIALE  
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 5654 Prot.  
Tiranë, më 26, 11 2025



MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA PËRGJITHSHME  
E BURGJEVE

Nr. 19410 Prot.  
Tiranë, më 26, 11 2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë, 26.11.2025, midis palëve:

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR, me adresë: Rruga e Durrësit, nr.83, Tiranë, me NIPT: J72216003P, përfaqësuar nga Znj. REME XHOLI, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, dhe

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE, me adresë: Rruga "Zef Serembe", Tufinë, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Klevis QOSE, bien dakord për lidhjen e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

### NENI 1 BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë";
- Ligjin nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale";
- Ligjin nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve";
- Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar
- Ligjin nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale",

- VKM nr. 518, datë 4.9.2018, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre”;
- VKM nr. 135/2018, “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar; që rregullon ligjshmërinë, sigurinë dhe llogaridhënien e përpunimit të të dhënave nga autoritetet publike dhe detyrimet për njoftim në rast cenimi, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## NENI 2 QËLLIMI

Qëllimi i marrëveshjes është bashkëpunimi i ndërsjellët ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit Social Shtetëror për krijimin e një mekanizmi bashkërendues për identifikimin në kohë të familjeve në nevojë, kryefamiljari i të cilave ndodhet në institucionet e vuajtjes së dënimit, kontaktimin aktiv, vlerësimin e nevojave dhe orientimin e tyre drejt gamës së shërbimeve dhe përfitimeve të parashikuara nga legjislacioni i mbrojtjes sociale dhe përkujdesit shoqëror me qëllim riintegrimin dhe përmirësimin e jetesës së tyre;

## NENI 3 FUSHA E ZBATIMIT

Kjo marrëveshje zbatohet për të gjitha familjet në nevojë, në të cilat kryefamiljari është vendosur në institucionet e vuajtje së dënimit, pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje .

## NENI 4 OBJEKTIVAT E MARRËVESHJES

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për evidentimin e rasteve të ndodhur në këtë situatë, kontaktimin dhe vlerësimin e shpejtë të nevojave, orientimin dhe informimin për akses në programet e ndihmës ekonomike, pagesave të aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, referimin dhe koordinimin teknik me bashkitë për verifikimin e rasteve që aktualisht janë duke marrë shërbime nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore si dhe rastet të cilat nuk janë evidentuar ende prej tyre.

## NENI 5 DETYRIMET E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve angazhohet të:  
Përcaktojë një punonjës si person kontakti i ngarkuar me këtë detyrë.  
Identifikojë rastet kur kryefamiljari dënohet me burg dhe dërgon listat në mënyrë periodike të këtyre familjeve te referuara si familje në nevojë pranë SHSSH duke përcjellë të dhënat bazë të familjes (gjendje civile, gjendje social-ekonomike, vendbanim, anëtarët e familjes, data e ekzekutimit të masës/dënimit, institucionit ku mbahet, personi i kontaktit të familjes etj).

Sigurojë bashkëpunimin e punonjësve socialë të institucioneve të vuajtjes së dënimit për verifikimin e situatës dhe kontaktin me familjen.

Njoftojë periodikisht nëpërmjet personit të kontaktit të DPB, çdo muaji rastet e reja me masë dënim me burg.

Dërgojë listat pranë SHSSH përmes rrugëve zyrtare të miratuara.

## NENI 6

### DETYRIMET E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Shërbimi Social Shtetëror angazhohet të:

Përcaktojë një punonjës si person kontakti i ngarkuar me këtë detyrë.

Koordinojë shpërndarjen e rasteve pranë Drejtorive Rajonale sipas vendbanimit të familjes brenda muajit nga marrja e listës.

Drejtoritë Rajonale të bashkëpunojnë me administratorë shoqëror në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të identifikuar rastet e familjeve nga lista e marrë nga DPB, që aktualisht janë pjesë e programeve të mbrojtjes sociale të ofruar prej tyre.

Verifikojë nëse familjet janë përfituese të shërbimeve të ofruar nga programet e mbrojtjes sociale për NE, PAK, SHKSH të ofruar nga Shërbimi Social Shtetëror.

Për familjet që nuk janë pjesë e këtyre shërbimeve të vijojnë me vlerësimin e rasteve si dhe orientimin drejt programeve kombëtare adekuate të mbrojtjes sociale sipas nevojave.

Drejtoria Rajonale kontakton me familjen dhe vlerëson rastin duke plotësuar "Formularin e Vlerësimit të Rastit" sipas Aneksit nr.1 në këtë marrëveshje.

DRSHSSH pas përfundimit të vlerësimit dhe orientimit drejt shërbimit, raportojnë periodikisht pranë SHSSH në bazë të listë së marrë për trajtim.

SHSSH raporton periodikisht informacionin e marrë nga DRSHSSH-të pranë DPB për rastet e trajtuara sipas Aneksit nr.2 në këtë marrëveshje.

## NENI 7

### PAKETA E MBËSHTETJES NË BAZË TË VLERËSIMIT

Orienton dhe asiston aplikimin për ndihmë ekonomike, sipas legjislacionit, ndjek statusin deri në përfundimin e procedurës së vendimmarrjes.

Informon për ndjekjen e procedurave për vlerësimin e aftësisë së kufizuar për rastet kur familja ka anëtarë me probleme shëndetësore.

Referon rastet për trajtimin drejt shërbimeve shoqërore e komunitare (informim, këshillim, orientim drejt qendrave ditore, shërbimeve në shtëpi etj) që ofrohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ose SHSSH.

Rasti mbyllet kur objektivat e planit janë përmbushur ose kur familja është integruar në skemat përkatëse.

## NENI 8

### MEKANIZMAT E BASHKËPUNIMIT

Palët krijojnë një mekanizëm koordinimi për shkëmbimin e informacionit dhe menaxhimin e rasteve. Palët raportojnë çdo 3 muaj lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, vlerësimet e

realizuara si dhe sipas rastit shërbimet e përfituara. Do të organizohen mbledhje të përbashkëta çdo 6 (gjashtë) muaj për të analizuar rastet dhe efektivitetin e masave të marra.

## NENI 9

### MËNYRA E KOMUNIKIMIT MES PALËVE

Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara. Personat e kontaktit janë si vijon:

- Për Shërbimin Social Shtetëror do të jetë **znj. Marsilda Petrela**,
- nr. Cel 0686020735
- E-mail: [marsilda.petrela@sherbimisocial.gov.al](mailto:marsilda.petrela@sherbimisocial.gov.al)

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve do të jetë **znj. Blerta Doçi**;

- nr. Cel. 0688027762
- E-mail: [blerta.doci@dphsh.gov.al](mailto:blerta.doci@dphsh.gov.al)

Personat e caktuar do të jenë përgjegjës për monitorimin e kësaj Marrëveshje.

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

## NENI 10

### KOHËZGJATJA DHE DISPONUESHMËRIA

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare, me të drejtë rinovimi. Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar më shkrim 1 (një) muaj përpara palën tjetër.

## NENI 11

### KONFIDENCIALITETI

Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion personal nuk do të komunikohet ndonjë palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

## NENI 13

### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje zgjidhet fillimisht me mirëkuptim ndërmjet palëve dhe në mungesë të tij, sipas legjislacionit në fuqi.


**NENI 14**  
**DISPOZITAT E FUNDIT**

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.
2. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.
3. Kjo marrëveshje nuk krijon detyrime financiare për asnjërën palë.

**PËR**  
**DREJTORINË E PËRGJITHSHME**  
**TË BURGJEVE**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**


**KLEVIS QOSE**



**PËR**  
**SHËRBIMIN SOCIAL**  
**SHTETËROR**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**REME XHOLI**



## ANEKS 1

### FORMULARI I VLERËSIMIT TË RASTIT

- Të dhënat identifikuese të familjes (emër, NID, adresë, përbërja familjare, numra kontakti).
- Të dhënat e rastit (data e dënimit, institucioni, kryefamiljari sipas certifikatës).
- Gjendja social-ekonomike (të ardhurat; strehimi; punësimi; mbështetje informale).
- Fëmijët dhe kujdesi (mosha, shkolla, kujdestaria, rrezik braktisjeje).
- Shëndeti dhe aftësia e kufizuar (indikacione për vlerësim AK).
- Shërbime të marra (NE, AK, shërbime komunitare/rezidenciale, statusi aktual).
- Nevoja emergjente (ushqim, strehim i përkohshëm, mbështetje psiko-sociale).
- Plani i rastit (objektivat, shërbimet, afatet, përgjegjësit).
- Data e mbylljes/rivlerësimit.

## ANEKS 2

### MODEL RAPORTIMI 3 MUJOR

- Raste të marra nga DPB: \_\_\_\_ ,
- Të kontaktuara brenda afatit: \_\_\_\_ ,
- Vlerësime të kryera: \_\_\_\_ .
- Orientuar në NE: \_\_\_\_ ,
- Orientuar në PAK: \_\_\_\_ ,
- Orientuar në shërbime të kujdesit shoqëror: \_\_\_\_ .
- Raste të mbyllura: \_\_\_\_ ,
- Raste në ndjekje: \_\_\_\_ ,
- Probleme/masa korrigjuese: \_\_\_\_ .

## ANEKS

### PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Ky Aneks është pjesë integrale e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit Social Shtetëror në mbështetje të familjeve të kryefamiljarëve të dënuar. Aneksi përcakton detyrimet për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe udhëzimet e komisionerit.

Palët në Marrëveshje :

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**, me adresë: Rruga “Zef Serembe”, Tufinë, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Klevis QOSE, që këtej e tutje i quajtur **kontrolluesi** dhe :

**SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**, me adresë: Rruga e Durrësit, nr.83, Tiranë, me NIPT: J72216003P, përfaqësuar nga Znj. REME XHOLI, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, që këtej e tutje i quajtur **përpunuesi**.

Përpunuesi pranon të përpunojë të dhëna personale vetëm për qëllimet e përcaktuara nga Kontrolluesi në kuadër të Marrëveshjes kryesore për bashkëpunim në mbështetje të familjeve të personave të dënuar.

#### Neni 1

##### Qëllimi

1. Kjo kontratë është lidhur mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit me qëllim që të ofrojë një mbrojtje të mjaftueshme në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale nga Kontrolluesi tek Përpunuesi me qëllim identifikimin, kontaktimin dhe mbështetja sociale e familjeve të personave të dënuar, në përputhje me ligjin dhe funksionet institucionale të palëve
2. Kjo kontratë zbatohet për të gjitha të dhënat personale të cilat delegohen për t’u përpunuar nga Kontrolluesi tek Përpunuesi dhe që përpunohen nga Përpunuesi për llogari të Kontrolluesit.

#### Neni 2

##### Përkufizime

1. Të gjithë termat e kësaj kontrate kanë të njëjtin kuptim si ato të përkufizuara në ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht ndryshe.
2. Për qëllimet e kësaj kontrate termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“**Kontrollues**” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci, kompani, organizatë apo institucion që mban, administron dhe kontrollon të dhëna personale dhe për qëllime të

përpunimit të tyre hyn në një marrëdhënie kontraktore me karakter outsourcing me një palë të tretë e cila në këtë rast quhet përpunuesi.

“Përpunues” është ajo pale e tretë e cila hyn në një marrëdhënie kontraktore me kontrolluesin me qëllim përpunimin e të dhënave personale me kosto më të ulët për llogari të kontrolluesit;

“Cënimi i të dhënave personale” është prekja e sigurisë së të dhënave që rezulton në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin, përhapjen e pa-autorizuar ose ndërhyrjen te të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunuara.

### Neni 3

#### Detyrimet e Kontrolluesit

1. Kontrolluesi garanton që të dhënat personale që delegohen për përpunim janë mbledhur dhe përpunuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontrolluesi garanton që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave te përpunuesi është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kontrolluesi është i detyruar që:

a) Përpara se të delegojë përpunimin e të dhënave personale të njoftojë subjektet e të dhënave në lidhje me këtë delegim, si dhe qëllimin e këtij delegimi;

b) Përpara se të delegojë përpunimin e të dhënave të informojë Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave personale sipas dispozitave të ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;

c) Të verifikojë masat teknike dhe organizative të ndërmarra nga Përpunuesi që sigurojnë mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave personale.

### Neni 4

#### Detyrimet e Përpunuesit

1. Përpunuesi ushtron funksionet e tij përmes strukturave të varësisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të cilat nuk janë ente të pavarura juridike, por pjesë përbërëse e të njëjtit person juridik publik.

2. Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së veprojnë në emër dhe për llogari të SHSSH, në zbatim të kësaj marrëveshje.

2. Përpunuesi është i detyruar që të përpunojë të dhënat personale të marra nga Kontrolluesi dhe çdo të dhënë tjetër që rrjedh prej këtij përpunimi:

a) Vetëm për llogari të Kontrolluesit dhe për qëllimet e përcaktuara nga Kontrolluesi;

b) Sipas udhëzimeve të Kontrolluesit; dhe

c) Në përputhje me këtë Aneks.

2. Përpara fillimit të përpunimit Përpunuesi merr të gjitha masat teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale të dërguara nga Kontrolluesi nga çdo përpunim i pa- autorizuar, duke përfshirë shkatërrimin, humbjen, përhapjen e paligjshme apo dëmtimin e tyre.

3. Përpunuesi njofton menjëherë Kontrolluesin në rastet kur:

a) Është në pamundësi të vazhdojë zbatimin e kësaj kontrate; ose

b) Ka ndodhur një prekje aksidentale apo e pa-autorizuar e të dhënave personale.

4. Përpunuesi nuk nënkontraktton kompani të treta për të bërë përpunimin e të dhënave pa miratimin paraprak me shkrim të Kontrolluesit.

## Neni 5

### Nën kontraktimi

1. Në rast të nën kontraktimit, Përpunuesi është i detyruar të sigurojë që:

a) Ka informuar paraprakisht Kontrolluesin dhe ka marrë miratimin e tij me shkrim;

b) Nën kontraktimi i përpunimit bëhet vetëm për veprime të rëna dakord në këtë kontratë;

c) Përpunuesi dhe Nënkontraktuesi firmosin kontratë sipas së cilës Nënkontraktuesi ka të njëjtat detyrime si ato të Përpunuesit sipas kësaj kontrate;

ç) Një kopje e kontratës së nën kontraktimit i dërgohet Kontrolluesit.

2. Në rast se Nënkontraktuesi nuk i përmbush detyrimet sipas kësaj kontrate, përgjegjësia për cenimin e të dhënave mbetet e Përpunuesit, sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

3. Kontrolluesi ka të drejtën që në çdo kohë të kontrollojë respektimin e kësaj kontrate nga ana e Përpunuesit, ose të kërkojë që ky kontroll të bëhet nga një palë e tretë e kualifikuar.

Në këtë rast Përpunuesi ofron bashkëpunimin e plotë dhe shpenzimet e kontrollit mbulohen nga Kontrolluesi. Në rast se nga kontrolli rezulton se Përpunuesi nuk ka vepruar sipas kësaj kontrate, shpenzimet e kontrollit mbulohen nga Përpunuesi.

## Neni 6

### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve në kontratë mund të arrihet me mirëkuptim. Në rast të kundërt palët i drejtohen gjykatës kompetente.

## Neni 7

### Sanksionet

Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të palëve të përcaktuara në këtë kontratë zbatohen sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

## Neni 8

### Afatet dhe përfundimi i kontratës

1. Kohëzgjatja e këtij aneksi është sipas afatit të parashikuar në marrëveshje.
2. Pas përfundimit të kësaj kontrate Përpunuesi:
  - I kthen menjëherë Kontrolluesit çdo të dhënë personale dhe kopje të tyre të dërguara nga Kontrolluesi, si dhe ato që kanë rrjedhur prej përpunimit;
  - Në rast se ky kthim është i pamundur, Përpunuesi shkatërron çdo të dhënë personale dhe çdo kopje dhe njofton menjëherë Kontrolluesin me shkrim;
3. Në çdo rast Përpunuesi është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuara apo të dhënave që kanë rrjedhur prej këtij përpunimi.

**PËR  
DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË BURGJEVE**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**KLEVIS QOSE**



**PËR  
SHËRBIMI SOCIAL  
SHTETËROR**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**REME XHOLI**

